



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH

Numri i lëndës: 2022:020510

Datë: 14.09.2022

Numri i dokumentit: 03420576

C.nr.7/22

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH – Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil, me gjyqtar Sabaheta Kurteshi dhe procesmbajtës Senida Nuri, në çështjen juridiko- kontestimore të paditësit M. Z., me vendbanim në fsh..., Komuna e Dragashit kundër të paditurit, N. B., me vendbanim në Dragash , lidhur me padinë për kthim të borxhit, vlera e kontestit 1.000,00 euro, jashtë seance me datë 14.09.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. KONSIDEROHET se **është TËRHEQUR** padia me nr. C.nr. 7/2022, e paditësit M. Z., me vendbanim në fsh..., Komuna e Dragashit, paraqitur kundër të paditurit N. B., me vendbanim në Dragash, lidhur me padinë për kthim të borxhitë, vlera e kontestit 1.000,00 euro

II. Secila palë i mban shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Pranë Gjykatës Themelore në Prizren - Dega në Dragash, është iniciuar procedura civile sipas padisë të paditësit M. Z., me vendbanim në fsh..., Komuna e Dragashit kundër të paditurit N. B. me vendbanim në Dragash , lidhur me padinë për kthim të borxhit, vlera e kontestit 1.000,00 euro.

Kjo gjykatë ka pranuar parashtrësën nga ana e paditësit me datë 13.09.2022, me të cilin ka kërkuar nga gjykata që padia të konsiderohet si e tërhequr për shkak se i padituri ka kryer detyrimet e tij

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës ku Secila palë i mban shpenzimet e veta procedurale, gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 450 të Ligjit të Procedurës Kontestimore Nr. 03/L-006 (LPK).

Gjykata në kuptim të Neneve 142.1, 261. par.1 lidhur me nenin 387.1 pika c të Ligjit të Procedurës Kontestimore Nr. 03/L-006 , vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2022:020510, 14.09.2022**

Procesmbajtësi

Gjyqtarja,

Sabaheta Kurteshi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.